



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE  
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHETIT

***N J O F T I M***

***PËR KANDIDATËT APLIKANTË PËR REGJISTRIM NË PROVIMIN E SHETIT NË PROFESIONIN E RREGULLUAR  
TË MËSUESIT, SEZONI XIX***

Për të gjithë kandidatët aplikantë për regjistrim në provimin e shtetit në profesionin e rregulluar të Mësuesit, ju bëjmë me dije se aplikimi do të kryhet online përgjatë periudhës **1 – 7 Prill 2024**, duke përdorur shërbimin “Aplikim për provim shteti” në platformën e-Albania.

Programet orientuese të provimit të shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit dhe fondet e pyetjeve sipas profileve gjenden të publikuara në faqen zyrtare të QSHA [www.qsha.gov.al](http://www.qsha.gov.al).

Programet orientuese të testimit të informatizuar të mësuesit për kandidatët të cilët duan të punësohen në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar gjenden të publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar [www.ascap.edu.al](http://www.ascap.edu.al), ndërsa fondet e pyetjeve për këtë testim gjenden të publikuara në faqen zyrtare të QSHA [www.qsha.gov.al](http://www.qsha.gov.al)

Gjatë aplikimit online, kandidati duhet të ngarkojë dokumentet e mëposhtme:

- 1. Diplomën/diplomat e programit të studimeve për profesionin respektiv;*
- 2. Dëshminë e pjesëmarrjes dhe përfundimit me sukses të praktikës profesionale të lëshuar nga institucioni kompetent për kryerjen e praktikës, ku përcaktohet edhe kohëzgjatja;*  
*\* Në raste të caktuara: Vërtetimin për njohjen dhe njësimin e diplomës në rast se studimet janë përfunduar jashtë shtetit; Dokumentacion të lëshuar nga institucioni përgjegjës për arkivat që provon lëshimin e diplomës apo dokumentit të barasvlershëm me të, të fituar nga institucioni i arsimit të lartë të mbyllur. Dokumenti që vërteton e vlefshmërinë e diplomës/diplomave të lëshuara.*
- 3. Vetëm pas njoftimit të pranimit nga DRAP, faturën e pagesës së kryer për llogari të QSHA-së, e cila duhet të ngarkohet në sistem në fushën që shfaqet pas vendosjes së kodit të gjurmimit dhe kodit të sigurisë, brenda 72 orëve nga njoftimi i pranimit.*

Lidhur me aplikimin e shtetasve të huaj, lutemi që pasi të zgjidhet shërbimi “Aplikim për provim shteti” në platformën e-Albania, të zgjidhet opsioni “shtetas i huaj” dhe të plotësohen fushat e kërkuara.

Kandidatët do të njoftohen në çdo fazë të aplikimit nëpërmjet postës elektronike si dhe portalit e-Albania në rubrikën Hapësira ime – Mesazhet e mia. Gjithashtu me anë të kodit unik të gjurmimit mund të gjurmohen në çdo kohë statusin e aplikimit.

***Kandidatët të cilët rezultojnë të suksesshëm në provimin e shtetit, menjëherë pas përfundimit të provimit, kanë të drejtë t'i nënshtrohen direkt testimit të informatizuar të mësuesit, për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, ndërsa kategoritë e tjera, do të mund të regjistrohen në testimin e informatizuar të mësuesit, për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, në sezonin e portalit i cili do të planifikohet pas muajit Qershor 2024.***

- Kandidati duhet të paraqitet pranë QSHA-së 30 minuta përpara orarit të publikuar dhe të jetë i pajisur me:
  - Letërnjoftim (Kartë ID ose Pasaportë, dokumenti origjinal);
  - Kopje të Kartës ID ose Pasaportës;
  - Faturën origjinale me vulën përkatëse, të pagesës së tarifës së provimit për llogari të QSHA-së, të kryer në një bankë të nivelit të dytë (sipas faturës për arkëtim të publikuar në [www.qsha.gov.al](http://www.qsha.gov.al), bazuar në herën e pjesëmarrjes në provim).
- Kandidati gjatë zhvillimit të provimit duhet të zbatojë rregullat e mëposhtme:
  - ndalohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve apo mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter mos kualifikimi;
  - ndalohet komunikimi me kandidatët e tjerë gjatë zhvillimit të provimit deri në marrjen e deklaratës së rezultatit;
  - ndalohet lëvizja përtej vendit të përcaktuar për zhvillimin e provimit;
  - ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit.

Kalendari i zhvillimit të sezonit dhe orari i provimit për çdo kandidat, do të publikohen në vijim në faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore [www.qsha.gov.al](http://www.qsha.gov.al). Orari i pjesëmarrjes në provim do të jetë i përcaktuar dhe nuk do të ketë ndryshime përtej orarit të publikuar.

Për të gjithë kandidatët e regjistruar, lutemi të verifikojnë paraprakisht të dhënat, në faqen zyrtare të QSHA-së [www.qsha.gov.al](http://www.qsha.gov.al) dhe në rast pasaktësish t'i drejtohen ZVAP/DRAP përkatës.

***Ju urojmë Suksese!***